



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.103/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP Geci Autokton me seli në Gjakovë kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditues të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.271/2018 të datës 15.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.271/2018 të datës 15.06.2020, Prishtet, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit NTP Geci Autokton me seli në Gjakovë, si e bazuar, nën pikën II. Anullohet aktvendimi nr.01.3.2.2/838 i datës 10.01.2018 i Doganës së Kosovës. nën pikën III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës, që paditësit, t’ia pranoj vlerën realisht të paguar sipas faturës përcjellëse për mallin lëndor sipas DUD-it kontetsues nr.9433 dt.16.05.2015 dhe të lejohet paditësi që mallin lëndor të paraqitur për zhdoganim, ta zhdoganoj sipas dokumentacionit përcjellës të mallit përkatësisht vlerës së faturës, si dhe ta liroj paditësin nga gjoba kundërvajtëse doganore në vlerë prej 1,000.00€ të ndëshkuar me vendimin 03.1.7-2017/509/2 i datës 09.11.2017, nën pikën IV. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; zbatimit të gabuar të drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje esenciale të dispozitave te procedures LKA-së, me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, të prish Aktgjykimin A.nr.271/2018 i datës

15.06.2020 si të pa bazuar në ligj, ta Refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në përgjigjen në ankes, i autorizuari i paditësit, i kundërshton pretendimet ankimore të paditures, dhe thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe tërsisht i ligjshëm, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paditures Dogana e Kosovës, kurse aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj në tërësi si të ligjshëm dhe të arsyeshëm.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 i LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankes, dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura, në rivendosje, me aktvendimin nr. 01.3.2.2/838 të datës 10.01.2018, e ka Refuzuar kërkesën e e subjektit në procedurë paditësit NTP Geci Autokton me seli në Gjakovë, për rishqyrtimin e vendimit numër 03.1.7-2017-509/2 dates 09.11.2017 të Sektorit për Kundërvajtje, si e pabazuar, Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar padi në konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lart cekur, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor dates 15.06.2020, e duke u bazuar edhe ekspertizën financiare, bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit, jepen vlersimet faktike dhe juridike te gjykates, se paditësi mallin lëndor e ka paraqitur në përputhje me numrin tarifor të përcaktuar në TARIK-un e integruar të Kosovës, pra përshkrimi i mallit në DUD-in kontestues është i njëjti siq është përcaktuar me kodin tarifor 34060000 qirinj, qirinjë të hollë dhe të ngjashme të tyre, qirinj të thjesht. Këtë konstatim dhe vlersim gjykata e mëbshtet edhe në bazë të vërtetimit të gjendjes faktike për mallin lëndor nga eksperti financiar të dhënë në ekspertizën financiare datës 03.02.2020. Gjykata konstaton se paditësi deklaratave doganore i ka bashkangjit faturen e mallit lëndor, që dëshmon çmimin e mallit lëndor, referuar nenit 123 të U.A. 11/2009.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n), 183, dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së, dhe si tillë është jo i plotë.

Kolegji, i Dhomave të Shkallës së Dytë, shqyrtoi me kujdes shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: Ekziston vërtetimi i gabuar apo

jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

E paditura në ankesën e saj ka potencuar se gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkespadin e paditësit pa prezantuar asnjë transaksion bankar për të vërtetuar se vlera e mallit të paguar është reale, dhe në anën tjetër ka kundërshtuar përgaditjen dhe përvojën profesionale të ekspertit financiar për të bërë ekzaminime fizike të mallit, përshkrimin tarifor të mallit si dhe nëndarjet e përshkrimin të mallit në rubrikën 31 të deklarimit të mallit.

Dhomat e shkallës së dytë, gjatë vlerësimit të provave në lëndë, të cilat i ka administruar dhe cekur në arsyetim të aktgjykimit, konstatohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë të qartë dokumentacionin përcjellës të mallit, me të cilin dëshmohet se është paguar vlera e mallit lëndor nga neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Të vetmin argument që e ka marrë për bazë gjykata e shkallës së parë është fatura e mallit lëndor, përderisa dispozita ligjore e nenit 33 të këtij Kodi përcakton:

Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë

Gjithashtu Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vëren se e paditura në rivendosje, nuk i është përmbajtur praktikave të veta me rastin e kontestit të klasifikimit tarifor të mallit lëndor të deklaruar nga paditësi me Deklaratën Unike Doganore R-9433/16,05.2015, duke formuar një komision në përbërje prej tre antarve, duke anashkaluar kështu Sektorin e Tarifës nga Dogana e Kosovës.

Kolegji e konsideron të papranueshme vendimin e gjykatës së shkallës së parë, caktimin e një eksperti financiar për të vërtetuar saktë klasifikimin tarifor në të cilin ishte dashur të deklarohet malli kontestues sipas TARIK-ut.

Në rastet e tilla kur ngritet dilema e përcaktimit të drejt të klasifikimit tarifor të një malli doganor, Kolegji vleron se e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka autorizime ligjore nga neni 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të lëshoj informacion të detyrueshëm tarifor. Mirëpo në rastin konkret e paditura ekzaminimin fizik të mallit lëndor kontestues e ka bërë përmes një komision prej tre antarve, i cili komision ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk ka deklaruar saktë llojin e mallit në tri pozicione: qirinj dekorativ në peshë prej 1,113.05kg, qirinj në gota/mbajtëse nga xhami me peshë neto prej 841.00kg dhe qirinj aromatik me peshë neto prej 634.00kg, nga e cila gjendje faktike paditësi ndëshkohet për kryerje të kundërvajtës doganore nga neni 276 pika (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, mos deklarim i saktë i llojit të mallit në tri pozicione të deklaruar me DUD-in R-9433/16.03.2015.

Andaj, sipas Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, gjykata e shkallës së parë ka pasur obligim të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe të gjitha provat e administruara që ka ofruar paditësi para gjykatës dhe paditures, ashtu që nga ballafaqimi i provave të nxjerra gjatë procedimit administrativ, dhe provave të siguruara gjatë procedurës së konfliktit administartiv, të nxjerr konkluzion të drejt sa i përket kontestit të klasifikimit tarifor të mallit lëndor. Mirëpo Kolegji

nga shkresat e lëndës, gjen parregullsi të udhëhequr në procedurën administrative duke mos u respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, dhe gjithashtu gjykata e shkallës së parë, për të vërtetuar gjendjen faktike se cilit kod tarifon i takon malli lëndor kontestues, cakton ekspert financiar i cili nuk i takon kësaj lëmie doganore.

Kolegji vleron se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, sepse pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, përmban të meta, dhe është i pakuptueshëm, sepse nuk precizohet shumat e detyrimit që duhet e paditura t,ia paguaj paditësit, sipas faturës përcjellëse për mallin lëndor të deklaruar sipas DUD-it R-9433 dt.16.05.2015.

Dhomat e shkallës së dytë nuk aprovoi pretendimet ankimore se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, neni 182.2 pika (k). Në shkresat e lëndës por edhe përgjigjes në ankes, i autorizuari i paditësit ka bashkangjitur Autorizimin e noterizuar LRP.Nr.2467/2019 REF.nr.561/2019 Noter Arbër Sadiku, me të cilin Gjokë Geci pronar i NPT Geci Autokton nga Gjakova, autorizon Ilir Geci nga Gjakova, që ta përfaqëoj në gjykatë.

Për arsyet e dhëna më lartë, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset, dhe qështja ti kthehet Dhomave të shkallës së parë në rigjykim, për ti mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, 183, 184 të LPK-së, që janë të atilla që pengojnë vlersimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur.

Në ri procedurë Dhomat e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës administrative. Dhomat e shkallës së parë sipas nevojës dhe kërkesave të palëve ndërgjyqëse, të siguroj prova përmes ekspertizës në lëmin përkatëse, me qëllim të konstatimit të saktë të klasifikimit tarifor të mallit kontestues, ndërsa kontestin e rivlersimit të mallit, ta vlersoj sipas argumenteve që ofron pala paditëse, në vështrim të nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.103/22 me datë 07.09.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha